



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:139185  
Datë: 13.03.2024  
Numri i dokumentit: 05447946

P.nr.2989/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoreshen profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit F.J., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.3120/2018 të datës 20.06.2018, jashtë seancës, më datë 13.03.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

I. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.3120/2018 të datës 20.06.2018 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit F.J., i lindur me ....., me vendbanim në ....., lagja “.....”, ....., ....., me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

II. E dëmtuara KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 28.06.2019, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.3120/2018 të datës 20.06.2018, kundër të pandehurit F.J., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në këtë çështje penale ka arritur afati kohor i parashkrimit absolut të ndjekjes penale për të pandehurin F.J.. Nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri është akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, për të cilën sipas kodit penal Kodi Nr.04/L-082 i cili ka qenë në fuqi në kohën e pretenduar të kryerjes së kësaj vepre penale, parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, për veprën penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tri) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale apo nga veprimi i fundit procedural, (parashkrimi relativ), kurse sipas dispozitës

së nenit 107 par. 8 të KPRK-së ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Bazuar në dënimin që parashihet për këtë veprë penale, rezulton se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekje penale, pasi që nga shkresat e lëndës, si dhe nga përshkrimi si në aktakuzë, del se vepra penale pretendohet se është kryer me datë 07.03.2018, në anën tjetër në kuptim të nenit 107 par. 1 të KPRK-së afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale të pretenduar, e deri në ditën e përpilimit të këtij aktvendimi kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) vite, respektivisht në këtë çështje penale afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale ka arritur me datë 07.03.2024, prandaj edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 3 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale dhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1 në nën paragrafi 1. 3, si dhe nenit 453 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

P.nr.2989/18

Me datë 13.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Dibran Jusufi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.